

Martin Kuka

poezi
prozë poetike

ATHINË, 2017

KUR MË KËRKONIN TË HAKMERRESHA

dy varre të hapura
tri hije mbi to

njëra bërtet
tjetra qan
e treta varr

unë i shoh
por nuk guxoj
dëgjoj
por mundohem të harroj

më tremb e qara
(diçka duhet të bëjë)
më frikëson e britura
(diçka kërkon të bëhet)
më tmerron heshtja
(diçka do të urdhërojë)

zëri ngrihet
e qara zgjatet
heshtja mbretëron

heshtja thyhet
(gjakmarrje urdhëroi)

KUR MË MALLKONTE

djalosh mos qaj
mos u përgjëro
mos u zvarrit
e meriton këtë vend
u mallkove
(nga ajo)

– nuk u mallkova me të drejtë

s'ka rëndësi e drejta
rëndësi ka mallkimi
më mirë
që padrejtësisht erdhe këtu

paçka se vdiqe duke u zvarritur
padrejtësia të ushqen urrejtje
ky është vendi i urrejtjes
urrejtja të ushqen forcë
ky është atdheu i forcës
i forcës më të madhe se ajo që ndolli urrejtjen e saj
forca është urrejtje
besomë
unë jam Juda
monarku i skëterrës
monarku i urrejtjes
mbreti i të urryerve
mbreti yt
forca e urrejtjes time mposhti hyjninë e nëntokës
në mbretërinë e tij
kjo është mbretëria ime
djalli humbi
në parajsë kërkoi mëshirë
duke u zvarritur si ti
u fal
kupton
djalli u fal
u fal si çdokush që kërkon falje

veç unë s'kërkova falje
veç unë s'u zvarrita
veç unë vara veten
sapo kuptova se isha frymëzuar për të tradhtuar
sapo kuptova se kisha lindur për të tradhtuar
sapo kuptova se pa mua

sakrifica s'do të kishte ndodhur
dhe njerëzia s'do të shpëtonte kurrë
sapo kuptova se u tradhtova që të shpëtonte njerëzia
njerëzia që zvarritet si ti

tani dua ushtarë
njerëz të urryer
katërcipërisht të urryer
me ta do të sulmoj parajsën
me ta do të shkatërroj parajsën

në fund të luftës
ata të frymëzuarit që shkruan të ardhmen do të
kërkoj
ata do të kryqëzohen të parët në parajsë
pas tyre At e Bir
që kurdisën çdo gjë

mos harro
po të flet Juda
ai që mbajti premtimin që dha qysh para se të lindte

KUR FLUTUROJA

Po fluturoja një natë. Isha i qetë e plot vendosmëri. Nga e para re e zezë që hasa pashë mbi tokë një shkëndijë të kuqe. Ndoqa pikat e shiut dhe drejt saj shkova.

Ishte një zjarr, një zjarr i madh, i ndezur të digjte dikë ... një vajzë ... (si) një re të tejdukshme mes furtunës. Pyeta për të por askush nuk guxoi të flasë. Ama guxuan ta flaknin në zjarr. Unë u turra menjëherë për ta shpëtuar, por ajo u shkrumbërua vetëtimthi. Veç kafkën e saj që ende digjej arrita të shpëtoj.

Me të në dorë e me zjarr në trup fluturova drejt shpirtit të saj. E mbërrita pranë resë së zezë dhe e pyeta pse ia dorëzoi trupin aq lehtë zjarrit.

–Ti pse vonove aq shumë? – m’u përgjigj pa u kthyer nga unë.

Ashtu i lagur e i shuar nga shiu qëndroja me kafkën e saj në dorë. Veç dora kafkëmbajtëse digjej ende.

– Se s’të doja – iu përgjigja duke lëshuar kafkën dhe zjarrin.

Shiu zjarrin shoi e kafkën treti. Shpirtin e saj e lashë duke mbajtur pikat zjarrfikëse dhe kafkëtretëse të shiut. Unë kalova në anën tjetër të resë e më pas u nisa drejt një tjetre. Domethënë vazhdova rrugën.

KUR DHUNOJA

po mundohem
po mundohem ta kap – i thashë
kjo flutur është jo si të tjerat
kur e prek dora ime ndryshon formë e rrëshket mes
përroit
kur afrohet këmba ime ndryshon ngjyrë e humbet
mes luleve
kur afrohen buzët e mia gjemba mbijnë kudo përreth
kur afrohem unë drita shuhet e ajo fshihet në errësirë

duhet të jetë flutur e bahçes së saj
vetëm ajo më shmangej kështu
vetëm ajo nuk e duronte praninë time
por përderisa atë vajzë e bëra timen
dhuna që duhet të përdor mbi këtë gjalleskë
është e pallogaritshme

KUR DËNOHESHA PA TË DREJTË

M'u afrua dhe më foli.

– Pse?

Nuk iu përgjigja.

– Pse ... pse?

– Nuk mund ta kuptosh – i thashë.

– Pse? – përsëriti duke marrë frymë thellë.

Nuk fola, veç e shikoja.

– Pse? – ulëriti duke më goditur me forcë. – Fol, pse? – ... dhe lotët i rrodhën rrëke.

Rojet nuk u treguan të zellshëm të më mbronin. Kur u afruan dhe e mbajtën disi nisa të flas.

– Ti je fajtorja. Prej teje ndodhi çdo gjë. Ti na shkatërrove të gjithëve. Thuajmë, a vleu? A vleu zgjedhja që bëre? E preke qiellin në sytë e tij? Shpreso! Sepse nëse nuk përjetove të vetmen gjë që të tërhoqi tek ai, atëherë e meriton dyfish këtë

gjëmë që të gjeti, këtë gjëmë që na gjeti. Ai vdiq, të tijtë vdiqën nga hidhërimi. Unë do të vdes, të mitë po vdesin nga marazi. Ti vdiqe, por ndoshta ringjallesh. Gjithë këto vdekje! E për çfarë? Vetëm sepse sytë e tij qenë qiellorë. Vetëm për një palë sy dënove me vdekje gjithë këta njerëz. Sy që as nuk t'i hidhte ndonjëherë. Kurse unë ... unë ... eh, ti e solle këtë! Ti dhe askush tjetër. Ti duhet të dënohesh nga këta njerëz, jo unë.

M'u vërsul duke shkërfëlluar dhëmbët e më lëshuar thonjtë në grykë, duke më sharë e mallkuar e ulëritur, duke më shkelmuar e pështyrë e goditur. Por kësaj rradhe njëri nga rojet nuk e la. Si e tërhoqi me forcë prapa dhe urdhëroi tjetrin ta nxirrte jashtë, m'u afrua e më pëshpëriti – e meritonte – duke më rënë mbi supe. Nuk e ngrita kokën, por isha i sigurt që sytë i kishte si të mitë.

KUR JETOJA NË PYLL

Në një pyll të qetë jetojnë njerëz të bukur. Jeta është e qetë si pylli. Mëngjeseve fëmijët luajnë, gratë e burrat punojnë. Pasditeve të gjithë argëtohen. Gjithmonë një kua në mes të pyllit sjell të njëjtat ujëra. Në këtë pyll jetoj dhe unë.

Nga pema më e lartë e pyllit tonë dallohet një tjetër përbri. Atje kroi bëhet lumë e përmyt gjithçka, dhe kthehet sërish në kua sapo kalon pemën e fundit të këtij pylli. Atje burrat luftojnë me njëri-tjetrin, fëmijët dhunohen e gratë përdhunohen. Atje natën nuk fle njeri i qetë, dhe të gjithë ëndërrojnë të arratisen në pyllin tonë. Në pyllin tonë vetëm unë ëndërroj të arratisem në pyllin përbri. Por në vend që të nisem drejt jetës, qëndroj në vend e shkruaj.

KUR KOPJOJA TË TJERË

- ti që di më thuaj sa njerëz poezojnë si unë?
- nuk kuptoj
- sa shprehen si unë?
- kopjojnë mërzinë time
- mërzinë time e bëjnë të tyren
- dhe e shkatërrojnë duke e shprehur nëpër letra
- nëpër ato fletë të bardha që lexojnë të gjithë ndy-
rësirat
- të gjithë ata që kërkojnë forcën te poezia
- ata janë dy, ti dhe ai
- kaq shumë?
- kaq shumë!
- ai do vrrarë!

– jo! po e vrave bëhen dhjetë ata që poezojnë si ti
– nëse vras veten ama...
– jo! atëherë bëheni një mijë
kurrë nuk do të jesh i veçantë
kështu do të vazhdosh
kështu do të vuash

por mos u mërzit shumë
je me fat
ai bëhet vet i njëqindtë
nëse të vret

KUR ISHA POETI MË I MADH

mallkova frikën dhe vendosa të shkoj përpara
por nuk munda
ishte momenti më i mirë për të poezuar
frika më kishte paralizuar
jam poet, jam frikëmadh

i pashë tek ecnin përpara meje
u mundova të dalloj më trimin
(nuk munda)
po ata e dinin cili qe?
nuk besoj

bile ata nuk dinin as cili mbrohej
fjalët e mia të frymëzuara
u hiqnin çdo hije dyshimi
se mes tyre dikush kishte frikë

jam poet
jam frikëmadh
jam mashtrues

KUR RENDJA NGA MARAZI

numrat nuk kanë fund – më pati thënë dikur
atëherë e lashë ta besonte atë marrëzi

numrat kanë fund
unë e kam parë
lidha dashurinë time pas të fundit
doja ta ndalja e t'i tregoja sa gabim e kishte
dashuria ime për të ishte e patundshme
ndaj e përdora për të ndalur numrin e fundit
të mos largohej më prej saj

ajo më la
unë çlirova numrin e fundit

vrapoj më shpejt se ai të arratisem prej saj
që qëndron në mes tyre
e palëvizshme e fuqiplotë
e pamohueshme
megjithëse mban emrin e asgjësë

dashurinë e humba diku midis pafundësisë
së qënies time
dhe asgjësë së saj

KUR LUFTOJA ME TRIMËRI

kujtoja trenin
mbushur me ushtarë
të gjithë të përhumbur
të gjithë të përlotur
të gjithë pa fjalë
unë në mes të tyre

kujtoja vagonin
mbushur me njerëz
mbushur me hije
mbushur me frikë
unë i pikëlluar në një cep të tij

kujtoja fjalët
që thyenin heshtjen
që thyenin të ftohtët
e bashkonin ushtarët rreth një strehe
rreth një vatre
rreth shpresës
unë pa fjalë por me shpresë
me shpresë se do të ikja
do t'arratisesha
do të zhdakesha
përpara se të mbërrinim në front

kujtoja vagonin tek zbrazej
ushtarët tek zbrisnin e vështroinin përreth
kujtoja veten tek humbisja shpresë
kujtoja ushtarët tek humbisnin shpresë
kujtoja si bërtisja e ulërisja
si hiqesha si i çmendur
si shkulja flokët
e gërvishtja fytyrën
si mbahesha pas hekurave të trenit
si u lutesha
u përgjunjesha e u përgjërroheshja
të më linin të ikja
të mos zbrisja nga burgu i vagonit
e t'i shmangesha lirisë së mejdanit

kujtoja si më shanin
si më pështynin e qëllonin
si më shikonin gjithë mllef e pështirosje

si më tërhoqën zvarrë
e si më hodhën në betejë

u përmenda mes zhurmash
tymrash
zjarresh
mes njerëzish që zvarriteshin e vraponin
që ulërisnin e bërtisnin
që vriteshin e plagoseshin
që çaheshin
shuheshin
treteshin
shpërthenin
gjymtoheshin e gjymtonin
që therreshin e therrnin të tjerë
që therrnin njerëz
therrnin kafshë
që therrnin dheun
therrnin ajrin
therrnin detin
therrnin tokën
therrnin dheun
therrnin dheun që mbaja në duar
në trup
në kokë e përbrenda

i shikoja e qeshja
qeshja më zë që humbiste mes qarjesh
mes britmash
krismash

shpërthimesh
gjëmimesh
e qeshjesh të tjera
i shikoja e kujtoja
kujtoja shtëpinë
kujtoja shokët
nënë, babanë
vëllezërit
kujtoja trenin
kujtoja vagonin
pastaj kuptoja që po kujtoja
e qeshura ikte
dhe veten e gjeja nën dhé
nën gurë
nën rrënoja
nën gjymtyrë
të mbuluar me jashtëqitjet e mia
të ushtarëve
e të çdo gjallese tjetër
të mbuluar me lotë
të mbuluar me tym
të mbuluar me gjak
të mbuluar me lotë
dhe vinte përsëri
menjëherë pas krismës së parë

KUR URREHESHA NGA STINËT

kjo poezi është si një verë e vjetër
e ruajtur për shumë vite
(vite me tri stinë)
e kyçur në një bodrum jo të pastër
por pa pluhur

nuk është pluhuri tregues
i vjetërsisë së kësaj poezie
por pastërtia
as ngjyra e kuqe gjakatare
ngjyra e të gjitha dashurive
por jo e times
e imja nuk ka ngjyrë
e imja e urren të kuqen

poezia ime kaloi dhjetë dimra
e struktur në një cep të bodrumit
nuk u ndie as gjatë shtatë vjeshtave që pasuan
gjithmonë ftohtë
gjithmonë shi
gjithmonë në të njëjtin cep

dashuria ime ishte e kuqe
por jo si të tjerat
e pastër si vera e poezisë sime
por më e vjetër
e moçme
e përhershme
jetoj një pranverë të tërë
një pranverë të tërë!
kaq e fuqishme ishte
aq sa tri stinët u zbehën
verat u ftohën
dimrat u zbutën
vjeshtat mbajtën gjethet
mblodhën forcat

poezia ime lindi kur verat u ngrohën
kur vjeshtat lëshuan gjethet
e dimrat vërsulën acarin
poezia ime jeton veç tri stinë
pranverën e zhdukën nga zemra ime
ajo u dënua në një bodrum

jo të pastër
ku pluhuri nuk guxon të afrohet

në atë cep bodrumi
dy roje të përjetshme vigjilojnë
njëra e armatosur me kujtimin
e dhimbjes e të lumturisë
tjetra me një laps e një letër
mbi to
qëndron fryti i dëshpërimit të tyre
poezia ime

KUR ISHA EGËRSIRË

Kalon përpara shtëpisë së tim padroni. Asaj shtëpie të rrënuar ku i pirë kthehej çdo natë e me inat të pandjerë nga një bishë si unë e mallkonte.

Unë bërtas e ulëras e çirrem, gërvish e shtyj e përplas derën që të hapet e t'i turrem aty në krye të rrugicës ku pret dikë. Dua ta copëtoj e t'ia shpie tim zoti te këmbët, poshtë trarit kryesor, ku i lidhur për qafe qëndron pa lëvizur e i heshtur në ajër.

KUR ISHA SHPËTIMTAR

kam vrarë dikë
të gjithë e shanë
të gjithë e qëlluan
të gjithë mllëfën nxorrën
e ndotën
unë e vrava

tek jepte shpirt nuk fliste
sytë e stërmadhuar nuk i lëviznin
goja gjysmë e hapur
nuk nxirrte asnjë fjalë
veç kapërdinte të miat

pamja e saj nuk shprehte asnjë mirënjohje

në fillim u inatosa
por më pas kuptova se dhe ajo
po shijonte momentin

KUR ISHA DERËZI

- si je o derëzi?
- nuk jam derëzi, jam derëbardhë.
- po a nuk je ti ai që i vranë babanë?
- po
- po ti nuk je ai që i vranë vëllanë?
- po
- po nuk je ti ai që i vranë motrën?
- po
- po atëherë si qenke derëbardhë, o mavri!?
- derën e shtëpisë im atë të bardhë e leu
gjakun e tij në derë im vëlla me të bardhë e lau
gjakut të tim vëllai ime motër të bardhë i shtoi

gjakun e saj unë me lotë e zbardha
unë jam më derëbardhë se ti
o njeri!

KUR KTHEHESHA NË VETVETE

dy njerëz të vetmuar qenë
u bashkuan dhe humbën vetminë
të bashkuar humbën veten
dhe u ndanë

ai
vetminë e gjeti aty ku e kishte lënë
të lënduar nga tradhtia
të brengosur nga vetmia

ajo
vetminë kërkoi aty ku e kishte lënë
të lënduar e gjeti
të brengosur e braktisi

përsëri
për një tjetër të vetmuar
që kishte vendosur të braktiste vetminë e tij

KUR DRUHESHA

dy fletore mbi një libër qëndronin
i pashë nga larg
paçka se rrëshkitën e u fshehën
sapo më panë tek afrohesha

i zhubrosa ndër duar
e i përplasa nëpër mure
u grisa kapakët
e u zhgarravita disa faqe
dashuria për mendimet që kisha hedhur në to
më ndali t'i digjja

tërbimit tim nuk i shpëtoi një laps
i shtrembër e i konsumuar deri në brez
që deshi të mësonte për dalldinë time

pasi e theva dhe e flaka në flakë
nisa t'i bërtisja më me forcë sesa britmat që ai
lëshonte
se dy fletore të hapura mendimesh të fshehta
mbi një libër kapakspiun
që mendohej përherë të mashtronte fletore
mendjelehta
të hapnin fletët
e t'i tregonin sekretet që hidheshin në to
do t'i dorëzonin poezitë e mia
mendimet e mia
sekretet e mia
botën time
dhe do ua rrëfente çdo vëllimi biblioteke
që të gajaseshin e të kënaqeshin
duke përqeshur poetin e tyre

KUR GËZOJA MOMENTET

mbajta frymën një moment
dielli i zhdukur
hëna e errët
nata e ftohtë
disa grimca shiu
unë vazhdoja të mos merrja frymë

sytë më digjnin
hapeshin e zgurdulloheshin
errësoheshin e verboheshin

sy idiotë

– mos u frikësoni
po gëzoj natën
nuk po mbys veten

KUR NDIHMOJA TË TJERË

Andej nga shkon era e vjetëruar e maleve kur vendin ia zë fryma e re, shkoja dhe unë i rrënuar nga të ftohtët. Era shpejtonte të më tregonte se s'kishte humbur aspak forcën e rinisë dhe se dëbimi i saj ishte i padrejtë. Në fillim doja që dëbimi im të mos kishte të njëjtë. Por kur era erdhi e i rrëfeu trupit tim ndodhinë e saj, u gëzova sepse kuptova që dhe ajo vajzë do ta pësonte nga dikush. Që nga ai moment detyra ime ishte të dëboja sa më tepër vajza, derisa të vinte dhe rradha e saj.

Era ishte vërtet shumë e ftohtë. Për t'iu shmangur u struka rreth një zjarri të ndezur nga vajza të hijshme.
– Ç'më shikon ashtu? – e pyeta tek e pashë të mër-zitej – Nuk kupton që po të ndihmoj!? Pas pak do të kesh mundësinë të provosh forcën tënde mbi trupin e njomë të njëres prej tyre.

KUR ISHA I PLOTFUQISHËM

Na kërkoi të poezionim forcën tonë, që të mësonite cili e donte më tepër. I pari fillova unë duke fushëzuar malet. Oqeanet i lumëzova mes për mes fushave, diellin e ndava në katër anët e tyre. Çdo gjë për të zhdukur hijen. Atë hije dyshimi që shprehu kërkesa e saj. Dyshimin se kishte forcë dashurie më të madhe se e imja.

Jo! Forcë të atillë nuk mund të gjeje. Por ajo ishte e verbër. Tjetri diçka i tha në vesh, i buzëqeshi dhe e puthi lehtë në faqe.

Më kthyen shpinën dhe ecën drejt maleve të tejlartësuar, oqeanëve të tejthelësuar e diellit të tejpërvëlur nga urrejtja e mashtrimit. Iu gjunjëzuan forcës time, e cila nuk kishte mundur të fitonte zemrën vocërrake të asaj bibe. Ç'turp për ta! Ç'vaj për mua!

KUR ISHA HERO

një gur kërkoi
veç një gur

pas gjithë luftës
i gjallë mbeta
pas gjithë furtunës
i gjallë kthehem
pas gjithë mallkimeve të perëndisë
drejt një guri të vetëm notoj

një gur kërkoj
në mes të oqeanit
veç një gur
të mbështetem pak
e të ngre grushtin drejt qiellit

KUR MË VARROSNIN

nga varri i saj veç dy brigje më ndajnë
dy brigjet e një lumi të egër
mospërfillës ndaj lutjeve të mia

mbi varrin e saj
mes barit të njomë
lule shumëgjyrëshe mbinë
u rritën
jetuan
u thanë
e mbinë përsëri
trupi i saj i tretur
dhe shpirti i saj i lirë
kujdesen për to

mbi varrin tim
veç toka e zezë, e ngurtë
rëndon
shpirti im rënkon
nuk guxon të lërë trupin
e të kërkojë të saj
në majën tjetër të malit
ka frikë
ajo nuk e di të vërtetën
ajo më mban mua fajtor
akoma

një mijë vite kaluan që kur na varrosën të dyve
në dy majat më të larta të malit
ku brigjet e një lumi
krijojnë kufijtë e hapësirës ndarëse
që shpirti i saj i kërkoi zotit të lumit

një mijë vite urrejtja për mua
e bën të lumtur
dhe lumin të egër ndaj lutjeve të trupit tim
që rënkon i groposur
bashkë me një shpirt frikëmadh
në këtë burg të nëndheshëm

KUR ISHA FITIMTAR

dje luftova
dje fitova

pas betejës
një shpatë mbaja në dorë
të pastër, pa gjak, pa njolla
veç disa pika gjaku ndaheshin te tehu i saj
binin në tokë e humbisnin
nuk mund t'i mblidhja
(dhe nuk doja)
gjaku që pikonte ishte jetëdhënësi i tokës
dhe vrasësi im
vrasësi im i tretë

në fillim ajo më vrau
kur refuzoi dashurinë time për një tjetër
për atë që dje luftova në prani të saj
atë që kur shpatën ia tejshkova në kraharor
retë lëshuan shi
por të trembura nga britmat e llahtarshme të saj
morrën arratinë
unë i tmerruar pashë djallin në fytyrën e saj
me shpatën e të vdekurit në dorë

shpatën nuk e përdori menjëherë
pranë meje erdhi
rrëmbeu timen
dhe kulloi gjakun mbi trupin e tij
asnjë pikë gjaku i të dashurit të saj
të mos vente dëm

gjaku im...
gjaku im lodronte në ajër
kur djalli me pallën e të vdekurit
iu vërsul trupit tim

si mbaroi më hodhi shpatën e pastër
mori të dashurin mbi supe
dhe e shpalli triumfant
të vetëvarë nga pendimi për aktin mizor
që kreu në prani të të dashurës

pa lëvizur vështroja qiellin
retë u dukën përsëri

inat më vinte që s'qanë për mua
por kur ndjeva shiun në fytyrë
i quajta hipokrite
duke i mallkuar të shporreshin nga mbi mua

KUR ECJA

me rrugën e lidha jetën
me atë rrugë nga ku gjithmonë kam kaluar
duke u menduar
duke u mërzhitur

mërzia kalonte sapo rrugës i vinte fundi
dhe unë ndjehesha i vetmuar
i braktisur dhe nga mërzia

KUR ISHA ME TË I HUMBUR

në ishullin e fundit të botës
në ishullin pranë humnerës
ku bien diejt çdo natë
isha me një vajzë
të bukur
si diejt e humbur
si ata që perëndonin pa u lindur
me buzë të njoma e të kuqe
si deti
kur ata diej të palindur perëndojnë të pikëlluar
pranë ishullit tim
me sy të qetë e nur të rëndë
si vargmalet përreth
kur hija e tyre mbulon çdo cep të ishullit tim

veçse këtyre maleve një re nuk u ndahej
lotët e vajzës zbrisnin faqen
digjnin gjelbërimin përreth
dhe përvëlonin shpirtin tim

ajo donte të largohej
por unë nuk mund ta lija
isha i vetmi në atë botë për të
e megjithatë
dashuria e saj për mua
ishte si dielli
që afrohej sa herë e gënjeja se do të iknim
dhe strukej në humnerën poshtë detit
disa momente më pas
kur ëndërronte botën tjetër
pa mua pranë

përveç lirisë
mund të më kërkonte çdo gjë
çdo gjë!

çdo gjë ajo nuk kërkoi
kërkoi diçka tjetër
mendoi se vdekja ime do të ishte i saji shpëtim

nuk di nëse kishte të drejtë
nga ishulli nuk u largua
(sekretin e mora me vete në varr)
por tani duket më e qetë

bile kur e kam më afër
kur dielli me mua përsipër kalon mbi të
më duket e lumtur

KUR ISHA DIKU

Diku, në majën më të lartë të gjithësisë, një poet kërkonte muzën. Dikush i pati treguar vendin, dikush tjetër majën. Mali e kishte ndihmuar t'i hipte përsipër, megjithëse nuk ishte bindur nga betimet e poetit. Majën e tij ta kishte shtëpijzuar një muzë!? Kaq matuf të ketë qenë!?

Në fillim nuk kishte pranuar. Askush nuk i kishte hipur mbi krye ndonjëherë, as dielli, as retë, asgjë. Diellin e lejonte t'i shkonte përpara për t'i shkrirë dëborat e ledhatuar thepisjet. Retë i kalonin veç rrallë përbri për ta larë e freskuar.

Kësaj rradhe, për çudinë e çdo gjëje, mali lejoi një poet, një poet dështak në kërkim të muzës.

– Ndoshta i erdhi keq?

– Jo! Fusha nuk bindej kurrë që këtij mali do t’i vinte ndonjëherë keq për diçka që i zvarritet te këmbët.

– Ndoshta poeti i premtoi ta plotfuqizonte me një poezi?

– Jo! Dielli i siguroi të gjithë se mali nuk kishte nevojë për disa fjalë (të pakuptimta) në një letër që të mahniteshin disa gjëra. Bile disa nga ata gjenin muzat e tyre veç duke soditur nga fushat madhështinë e tij.

– Ndoshta ...

– Jo! Asnjë gjë nuk bindej.

Atëherë një pemë ulliri mori fjalën.

– Dëgjoni, – tha – në vegjëli u dashurova pas një ulleshe të bukur, të ëmbël e pjellore. Ajo u dashurua më keq me mua. Fati ynë i keq bëri që ky mal të forcohej e të ngrihej shumë shpejt pranë nesh. Mua më zuri nga rrënjët, kurse të dashurën time e la rrëzë tij të thahej nga marazi. Mijëra mijëvjeçarë kaluan që nga ajo kohë. Ajo është ende e bukur dhe pjellore në zemrën time.

Ashtu si unë, besoj se dhe mali do të ketë dashuruar dikur. Këtë dashuri do e ketë akoma në zemër. Them se dashuria e këtij poeti për një muzë i kujtoi dashurinë e tij. Ndaj, i zbutur e i mallëngjyer, jo vetëm që e la t’i hipte mbi krye, por dhe e ndihmoi. Kush e di ç’po bën ky poet me muzën e tij aty mbi mal! Shpresoj të jetë i lumtur tashmë!

Kaq kishte për të thënë ulliri, mori thellë frymë dhe pa të tjerët. Të gjithë rrinin mendueshëm, të mallëngjyer në heshtje. Më në fund kishin kuptuar sjelljen e malit!

Mirënjohjen e tyre e shprehën menjëherë. Zogjtë qëndruan mbi ulli për t'i hequr insektet, dhe u rrënjëve u shkruftësua, shiu e lau, dielli e ngrohu, flladi i erës i ledhatoi gjethet dhe degët. Ah, parajsë! Ai mbylli sytë dhe shijoi atë mirënjohje të rrallë. Trupi nuk po i dhimbte më nga pozicioni i keq horizontal që kishte marrë që kur mali e rrëmbeu.

Por kjo nuk zgjati shumë. Era ia la trupin pasi dëgjoi një thirrme që vinte nga lart duke u shtuar. Çdo gjë e dëgjoi. Të hutuar panë poetin që binte drejt tokës, me sy të zgurdulluar e me gojë të stërhapur që nxirrte veç britma tmerri. Pas tij maja e malit ulej ta kapte para se ta zinte toka.

Teksa i afrohej tokës të gjithë pritnin të shikonin kulmin e tmerrit në pamjen e poetit. Për çudinë e tyre, pranë vdekjes ai nisi të bërtasë i lumtur – e gjeta, e gjeta! – Atë kulm tmerri e panë në sytë e majës së malit, sapo poeti preku vdekjen.

Nga gjithë ai hutim dielli u përmend i pari. Vetën e pa tek qëndronte mbi malin e përkulur. Menjëherë iu afrua dhe e dogji në anë. Mali briti dhe nisi të ngrihej. – Kush guxoi? – Por më shpejt u ngrit era. Tufani që ajo lëshoi i vështirësoi ngritjen. Retë lëshuan rrufetë e dielli u afrua akoma më shumë.

Masakra mori fund shpejt. Të gjithë u mrekulluan duke parë malin të copëtohej. Copat ranë mbi fusha. Fushat i dëbuan e i hodhën në det. Deti i vuri përfund, hapi themelet e i shtyu në ferrin e nxehtë të nëntokës. Mali u zhduk. Bashkë me të edhe poeti me ullirin fatkeq.

Atë që ndodhi të gjithë e kuptuan. Poeti nuk e gjeti muzën në krye të malit dhe u hodh nga marazi. Po mali pse i vajti nga pas? Shumë u thanë por asgjë nuk u pëlqye. Vetëm atëherë u kujtuan për ullirin plak, fama e të cilit si gjëja më e ditur kishte kaluar kufijtë e asaj gjithësie.

Mirëpo dhe ulliri kishte gabuar. Mali nuk kishte dashuri në zemër, por urrejtje për dikë. Prandaj dhe rrëmbeu ullirin nga e dashura e tij. Me forcën e urrejtjes së tij kishte fituar çdo betejë e pengesë që haste përpara në rrugën e tij drejt madhësisë.

Tashmë dielli sundon kryelartë, i ndjekur nga shikimet cmirëzeza të çdo gjëje.

JAM DJALL

pashë natën
të qetë
të zezë e pa ndjenja
pashë zjarrin e yllit tim
që mendohej të ndante ftohtësinë e natës
e drejt meje të dërgonte ngrohtësi
pashë malin më të lartë në imagjinatën e një poeti
me ty mbi krye
nën zjarrin e fundit të yllit tim
pashë lumin e poezisë sime
të qetë kësaj here
shumë të qetë
pashë veten time
të shtrirë mbi bar

të heshtur
të humbur

qava mbi trupin tim
qava për kujtimet e humbura në të

tani më mbeti veç vetmia
vetmia e qënies time
vetmia e ëngjëllit

KUR MË KËRKONIN TË HAKMERRESHA.....	5
KUR MË MALLKONTE	7
KUR FLUTUROJA.....	10
KUR DHUNOJA	12
KUR DËNOHESHA PA TË DREJTË.....	13
KUR JETOJA NË PYLL	15
KUR KOPJOJA TË TJERË	16
KUR ISHA POETI MË I MADH	18
KUR RENDJA NGA MARAZI.....	20
KUR LUFTOJA ME TRIMËRI	22
KUR URREHESHA NGA STINËT.....	26
KUR ISHA EGËRSIRË	29
KUR ISHA SHPËTIMTAR	30
KUR ISHA DERËZI	32
KUR KTHEHESHA NË VETVETE.....	34
KUR DRUHESHA.....	36
KUR GËZOJA MOMENTET	38
KUR NDIHMOJA TË TJERË.....	40
KUR ISHA I PLOTFUQISHËM	42
KUR ISHA HERO	44
KUR MË VARROSNIN	46
KUR ISHA FITIMTAR	48
KUR ECJA.....	51
KUR ISHA ME TË I HUMBUR	52
KUR ISHA DIKU.....	55
JAM DJALL	59

